

AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË
"IMPACT IMAGE STUDIOS" SHPK

Në bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar si dhe të ligjit 9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar, Ligjit nr 131/2015 Për Qëndrën Kombetare të Biznesit :

Bledar Laço, i biri i Thodharaq dhe Evdhoksi, i lindur më 26.09.1969 në Korçë, banues në Tiranë, me nr personal G90926094O, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

dhe

Redi Çadra, i biri i Defrim dhe Zonjë, i lindur më 14.09.1989 në Tiranë, banues në Tiranë, me nr personal I90914051T, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

shpallin si me poshte vijon:

Neni 1

Sot më 27.02.2024, Themelohet shoqëria e quajtur "IMPACT IMAGE STUDIOS" SHPK me dy ortak përkatësisht:

- Bledar Laço, i biri i Thodharaq dhe Evdhoksi, i lindur më 26.09.1969 në Korçë, banues në Tiranë, me nr personal G90926094O, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me 50 % të kuotave.
- Redi Çadra, i biri i Defrim dhe Zonjë, i lindur më 14.09.1989 në Tiranë, banues në Tiranë, me nr personal I90914051T, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me 50 % të kuotave.

Neni 2

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Rruga Beqir Luga, Pll 03, H15, Ap01 Tiranë. Shoqëria mund të themelojë degë dhe filiale në të gjithë territorin e vendit si dhe jashtë tij me miratimin e organeve kompetente dhe në përputhje me legjislacionin e vendit ku do të hapen keto agjensi.

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë:

Shërbim me Regji Televizive Levizëse, Trasmetime direkte, Regjistrime TV, evente sportive, artistike, takime sfilata, koncerte, spektakle etj.

Konulencë teknike, Asistencë, Konsulencë artistike, Organizim eventesh etj.

Import – eksport pajisjesh profesionale për transmetime TV.

Neni 5

Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron 50 % të kuotave.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë përbëhet nga 100.000 (njëqind mijë) lekë dhe është kontribut i Ortakeve si më poshtë :

- Bledar Laço 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë ose 50% kuotave
- Redi Çadra 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë ose 50% kuotave

Ortakët e shoqërisë mund të vendosin për rritjen e kapitalit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

Detyrimet e çdo ortaku kundrejt shoqërisë perballohen vetëm për pjesën e kapitalit të derdhur nga ai. Për detyrimet e tjera të shoqërisë ortaku nuk mban përgjegjësi.

Neni 6

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga organet e saj të cilat janë:

1. Asambleja e Përgjithshme.
2. Administratori

Shoqëria ka si ortak :

- Bledar Laço 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë ose 50% kuotave
- Redi Çadra 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë ose 50% kuotave

dhe administrator:

Redi Çadra, i biri i Defrim dhe Zonjë, i lindur më 14.09.1989 në Tiranë, banues në Tiranë, me nr personal 190914051T, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Mënyra dhe drejtimi i shoqërisë janë të përcaktuara në Statutin e shoqërisë.

Neni 7

Ortakët e shoqërisë janë të detyruar që të ruajnë sekretin e dokumentacionit dhe të informacionit si dhe eksperiencën e realizuar brenda kontekstit të shoqërisë dhe të evitojnë përhapjen e tyre qoftë dhe pjesërisht.

Neni 8

Në se shoqëria do të likuidohet atëherë do të caktohet një komision likuidimi që do të parashtrijë një bilanc likuidimi për miratim.

Neni 9


Çdo mosmarrëveshje që do të lindë në lidhje me këtë marrëveshje apo Shoqërinë (përveç atyre personale apo që nuk kanë të bëjnë me Shoqërinë), do të zgjidhet me mirëkuptim dhe do të diskutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje me mirëkuptim të mosmarrëveshjes, çështja do t'i kalojë për gjykim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAKET SHOQËRISË

"IMPACT IMAGE STUDIOS" SHPK

Bledar Laço

BLEDAR LAÇO


Redi Çadra

Redi ÇADRA
